

## Shpallje e interesit për ofrues të shërbimeve digjitale

### Informata të përgjithshme:

Iniciativa për Fuqizim Digjital (DEI) në kuadër Agjencionit për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë dhe në përkrahje të projektit Enabling Income Generation for the Poor (EnInGeP) dhe financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim është një mekanizëm mbështetës që synon të ofrojë shërbime të subvencionuara dhe efikase të Digjitalizimit të biznesit, për të mundësuar transformimin digjital të NVM-ve për periudhën 2024-2026.

Business Consultants Council si partner zbatues i projektit EnInGep dhe si shoqata e vetme që përfaqëson konsulencën menaxheriale në nivel lokal, fton kompanitë për shprehje të interesit si ofrues të shërbimeve digjitale në fushat vijuese:

- **Marketingu Digjital** - Madhësia e grantit 2,500 € + 20 – 40% pjesëmarrja e ndërmarrjes
- **Burime Njerëzore** përmes platformave të licencuara - Madhësia e grantit: 2,000 € + 20 – 40% pjesëmarrja e ndërmarrjes
- **E-Tregtia (E-Commerce) / Platformat e Shitjes Online** – Madhësia e grantit 3,500 € + 20-40% pjesëmarrja e ndërmarrjes
- **Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP)** – Madhësia e grantit 2,500 € + 20-40% pjesëmarrja e ndërmarrjes
- **Programe të ndryshme Automatizimi dhe Optimizimi** - Madhësia e grantit 4,000 € + 20-40% pjesëmarrja e ndërmarrjes

### Kriteret e përzgjedhjes për ofruesit e shërbimeve digjitale konsistojnë në:

- Të paktën 6 muaj në operim
- Nuk ka detyrime ndaj ATK-së ose ka marreveshje me ATK për shlyerjen e borxheve
- Të paktën tre referenca në fushën specifike të ofrimit të shërbimit digjital
- Dëshmi / Portfolio e projekteve/shërbimeve të kaluara të digjitalizimit (për kompanitë)

### Aktivitetet, përgjegjësitë dhe metodologjia e punës:

- Ofruesit e kualifikuar të shërbimeve digjitale do të pranojnë Termat e Referencave nga BCC, në të cilat specifikohen shërbimet të cilat do t'ju ofrohen ndërmarrjeve përfituese.
- Ofruesit e Shërbimit Digjital dërgojnë profilin e tyre me punet e ngjajshme dhe afatin e zbatimit të projektit në BCC jo më vonë se 3 ditë pas marrjes së ToR. Projekti EnInGep, në emër të Ekipit Menaxhues të DEI, i dërgon ofertën ndërmarrjes përfituese (aplikuese).
- Ndërmarrja përfituese duhet të zgjedhë ofruesin e shërbimit digjital jo më vonë se 3 ditë pune pas marrjes së vlerësimit dhe afatit kohor të zbatimit të projektit.

### Pagesa:

Ndërmarrja përfituese paguan në tërësi ofruesin e shërbimeve digjitale, përderisa KIESA përmes projektit EnInGep subvencionon në mënyrë të pjesshme koston e shërbimeve.

### Kompanitë e Implementimit:

Skema për kompanitë ofruese të shërbimeve digjitale, që përfshihen në skemën e shërbimeve të implementimit të projektit EnInGep në bashkëpunim me BCC, në kuadër të projektit Iniciativa për Fuqizim Digjital (DEI):

- Kompania aplikuese kushtëzohet të nenshkruajë marrëveshje për shërbime me BCC, ku zotohen t'i paguajë shoqatës BCC, 10% të shumës totale për secilën kontratë mes ofruesit të shërbimeve digjitale dhe ndërmarrjes përfituese. Pagesa karakterizohet si **processing fee** dhe duhet të paguhet nga kompania aplikuese në momentin që përzgjedhen nga ndërmarrja. Konfirmimet e pagesave duhet të dërgohen tek BCC brenda 3 ditëve të punes, që nga momenti i njoftimit për përzgjedhje.
- Kompanitë që paguajnë shumë procesuese (processing fee) mbi 350 EUR, do të përfitojnë anëtarësim falas në BCC që nga data e pranimit të pagesës nga BCC.

### Përfitimet për Kompanitë ofruese të shërbimeve digjitale:

Ofruesit e shërbimeve digjitale do të ketë mundësinë që gjatë këtij raundi të ofrojnë shërbime në vlerë deri në 450,000 EUR duke përfshirë 100 ndërmarrje brenda periudhës 2024 – 2025.

## **Procesi i aplikimit:**

Ofruesit e shërbimeve digjitale: Kompanitë e interesuara mund të aplikojnë në këtë thirrje të shprehjes së interesit duke dërguar dokumentet e mëposhtme:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- 3 referencat e lartcekura,
- Marrëveshja e nënshkruar nga kompania me BCC për processing fee – dokumenti mund të shkarkohet si aneks dokument (që gjendet në thirrjen e plotë) dhe duhet të dorëzohet i nënshkruar.
- Portofolio përkatëse që dëshmon zbatimin e projekteve apo ofrimin e shërbimeve digjitale,
- Vërtetimi Tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës – ATK (që biznesi nuk posedon borxhe ose ka marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxheve)

**Shprehjen e interesit për ofrim të shërbimeve** bashkë me dokumentet e kërkuara e dërgoni tek email

adresa: [applications.dei@gmail.com](mailto:applications.dei@gmail.com)

Thirrja do të mbetet e hapur vazhdimisht.

\*Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.